

VENDIM
Nr. 576, datë 22.7.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 723, DATË 19.11.1998, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7889, DATË
14.12.1994, ‘PËR STATUSIN E INVALIDIT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 723, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, ‘Për statusin e invalidit’”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, në masën 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë në vit, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit dhe programohen çdo vit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu